



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government*

|                      |  |                                  |
|----------------------|--|----------------------------------|
| Për:                 | Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt<br>Kristina Gashi Bytyqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt  |                                  |
| Kopje:               | Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë  |                                  |
| Përmes:              | Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së   |                                  |
| Nga:                 | Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave  | Datë: 22/02 /2021<br>Nr. 020-128 |
| Zyrtaret përgjegjës: | 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br>Driton Xhafa, Zyrtar për monitorim të komunave |                                  |
| Lënda:               | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajt  |                                  |
| Lloji i aktit:       | <input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës  |                                  |

I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nënin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

|  |
|--|
| Vendim Nr. 14 për dhënien në shfrytëzim të ngastrës nr.3273-0 zona kadastrale Ferizaj në sipërfaqe 1172m <sup>2</sup> ndërmarrjes publike Sistemi i Transmisionit dhe Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike, (KOSTT) |
| I miratuar më datë: 05.02.2021   |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 22.02.2021  |

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**




Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës   | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim  |
|-----|--|--|
| 1.  | Vendim Nr. 14 për dhënien në shfrytëzim të ngastrës nr.3273-0 zona kadastrale Ferizaj në sipërfaqe 1172 <sup>m2</sup> ndërmarrjes publike Sistemi i Transmisionit dhe Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike, (KOSTT) | <p>Vendim Nr. 14 për dhënien në shfrytëzim të ngastrës nr.3273-0 "KOSTT" bënë pjesë në kuadër të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për "raste të veçanta". Dhënia e pronës komunale në këtë rast është në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, <i>përkatësisht nenin 25 paragrafi 6 sepse:</i></p> <p>"Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim më qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, bëhet me vendim të kuvendit të komunës, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm <u>dhe nuk mund të jepet pa kompensim</u>"</p> <p>Andaj bazuar në të lartcekurat dhënia në shfrytëzim të ngastrës nr.3273-0 është bërë "<u>pa kompensim</u>" dhe si e tillë përben shkelje të "kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta" që janë përcaktuar në nenin 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020."</p> |

Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Ferizajt që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government*

|  |   |                                  |
|--|---|----------------------------------|
| Za:  | Agim Aliu, gradonačelnik opštine Uroševac<br>Kristina Gashi Bytyqi, predsedavajuća Skupštine opštine Uroševac |                                  |
| Kopija:                                      | Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u,<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini,            |                                  |
| Preko:                                       | Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a,<br>Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MLS-a,         |                                  |
| Od:  | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i<br>monitorisanje opština, MLS                                 | Dana, 22.02.2021.<br>Br: 020-128 |
| Odgovorni<br>službenik:                      | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje<br>opština MLS   |                                  |
| Službenik-ca za<br>izradu pravne<br>procene: | Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština  |                                  |
| Predmet:                                     | Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Uroševac  |                                  |
| Vrsta akta:                                  | Odluka Skupštine opštine  |                                  |

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premjera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

|   |
|---|
| Odluka br. 14 o davanju na korišćenje parcele br. 3273-0 katastarske zone Uroševac površine od 1172m2 javnom preduzeću Prenosni sistem i dozvola za operatora tržišta električne energije (KOSTT) |
| Usvojena dana, 05.02.2021.  |
| Predložena za razmatranje u MLS-u, dana, 22.02.2021.  |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ocenilo je da je, opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.



U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

| Br. | Formulisane u aktu opštine  | Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.   |
|-----|---|---|
| 1.  | Odluka br. 14 o davanju na korišćenje parcele br. 3273-0 katastarske zone Uroševac površine od 1172m <sup>2</sup> javnom preduzeću Prenosni sistem i dozvola za operatora tržišta električne energije (KOSTT) | <p>Odluka br. 14 o davanju na korišćenje parcele br. 3273-0 „KOSTT“ spada u okviru „posebnih slučajeva“ o davanju na korišćenje nepokretne opštinske imovine.</p> <p>Davanje opštinske imovine u ovom slučaju je u suprotnosti sa Uredbom (VRK) br. 09/2020, o određivanju procedura davanja na korišćenje i zamene nepokretne opštinske imovine, <i>odnosno člana 25 stav 6, jer:</i></p> <p>“Davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine radi ostvarivanja investicija u energetskom sektoru vrši se odlukom skupštine opštine, na osnovu važećeg zakonodavstva <u><i>i ne može se dati bez nadoknade.</i></u>”</p> <p>Stoga, na osnovu gore navedenog, davanje na korišćenje parcele br.3273-0 izvršeno je „<u><i>bez nadoknade</i></u>“ i kao takvo, predstavlja kršenje „<i>zahteva za davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine za posebne slučajeve</i>“ koji su definisani u članu 25 Uredbe (VRK) br. 09/2020.</p> |

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave *zahteva* od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Uroševac, preduzimanje konkretnih mera, kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



|  |  |  |
|--|--|--|
| REPUBLIC OF KOSOVO<br>KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ   |  |  |
| Ministry of Administration and Local Government<br>Ministria e Administrimit të Përkohshme Lokale<br>Ministry of Local Government Administration |  |  |
| Date: 05.02.2021   |  |  |
| -17-02c-128  |  |  |
| REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO<br>Ferizaj • Uroševac  |  |  |
| KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ   |  |  |

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI KOMUNAL  
SKUPSTINA OPŠTINE  
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.14  
Data: 05.02.2021

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03 L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 15, Qershor 2008) nenit 5, nenit 6, pika 1.2 dhe dispozitave të nenit 14 të Ligjit nr.06 L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 10/03, prill 2019) nenit 24 pika 1 dhe 2 e Rregullores (QRK) nr. 09/2020 dhe nenit 10 parafit 2.4 të Statutit të Komunës së Ferizajt, 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur: **05.02.2021**, miratoi:

**V E N D I M**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË NGASTRËS KADASTRALE 3273-0 Z.K.**  
**FERIZAJ**

**I**

Miratohet Propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të parcelës 3273-0 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe 1172m<sup>2</sup>, Ndërmarrjes Publike OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.KOSTT me numër identifikues 811284512 me adresë në Prishtinë rr. "Ihaz Kodra" Republika e Kosovës.

**II**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të parcelës së cekur në pikën I është ndërtimi i Nënstacionit NS 110/35/10(20) KV Ferizaj 3 si dhe traseja për linjën përcjellëse 110KV dhe nuk mund të shfrytëzohet për asnjë qëllim tjetër pa vendim të Kuvendit të Komunës së Ferizajt.

**III**

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A.KOSTT qasjen në parcelën e cekur në pikën I do ta realizoj përmes parcelave: 3249-2,497-4 pronë e Komunës së Ferizaj dhe përmes parcelës 496-8 me titullar pasuri shoqërore Kooperativë Bujqësore.

**IV**

Dhënia në shfrytëzim e parcelës së cekur në pikën I të këtij vendimi ipet pa kompensim për periudhën afatgjatë prej 99 viteve.

**V**

Obligohet Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit që pas miratimit të këtij vendimi të bëjë ndërrime në evidencat Kadastrale.





REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MUNICIPALITY OF FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJT

11.02.2021

No. 01  
 Br. 14  
 Str. 1

Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal  
 Ministri i Administrimit Lokal dhe Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

Data: 11.02.2021

Shk. 01-020-128

REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI KOMUNAL  
 SKUPSTINA OPSTINE  
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Br.14  
 Datum: 05.02.2021

U skladu sa odredbama člana 12. stav 12.2 tačka d i člana 14. stav 1. Zakona br. 03 / L-040. o lokalnoj samoupravi („Službeni list Republike Kosovo“, br. 28/15. jun 2003) član 5, član 6. tačka 1.2 i odredbe člana 14. Zakona br. / L-092 za zakup na korišćenje i zamenu nepokretne imovine opštine („Službeni list Republike Kosovo“ br. 10/03. april 2019) član 24 tačke 1 i 2 Uredbe (VRK) br. 09/2020 i člana 10. stav 2.4 Statuta opštine Uroševac. br. 50 od 28.06.2013. godine. Skupština opštine Uroševac. na sastanku održanom: 05.02.2021. usvojila je:

**ODLUKU  
 ZA DAVANJE NA KORIŠĆENJE KATAstarsKE PARCELE 3273-0 K.Z. UROŠEVAC**

**I**

Odobrava se Predlog gradonačelnika za dugoročnu dodelu na korišćenje parcele 3273-0 K.Z. Uroševac. površine 1172m<sup>2</sup>. Javnom preduzeću OPERATIVNI SISTEM. PRENOS I TRŽIŠTE A.D. KOSTT sa matičnim brojem 811284512 sa adresom u Prištini. "Iljaz Kodra" Republika Kosovo.

**II**

Svrha davanja u upotrebu parcele pomenute u tački I je izgradnja trafostanice SS 110/35/10 (20) kV Uroševac 3 kao i trase za prateću liniju 110KV i ne može se koristiti u bilo koju drugu svrhu bez odluka Skupštine opštine Uroševac.

**III**

Operator sistema, prenosa i tržišta AD KOSTT će putem parcela realizovati pristup parceli pomenutoj u tački I: 3249-2.497-4 imovina opštine Uroševac i preko parcele 496-8 sa naslovom društvene svojine Zemljoradnička zadruga.

**IV**

Dodela na korišćenje parcele pomenute u tački I ove odluke daje se bez naknade za dugoročni period od 99 godina.

**V**

Direkcija za imovinu, geodeziju i katastar dužna je da izvrši izmene u katastarskim evidencijama nakon odobrenja ove odluke.

**VI**

O sprovođenju ove odluke staraće se gradonačelnik Uroševca. Direkcija za imovinu, geodezija i katastar.

**VII**

Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u Kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za lokalnu samoupravu i objavljivanja na službenim jezicima na veb stranici opštine.

Predsedavajuća Skupštine opštine  
 Kristina Gashi Bytyçi





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E PRONËS, GJEODEZISË DHE KADASTRIT  
UPRAVA IMOVINE, GEODEZIJE I KADASTRA  
DEPARTMENT OF, PROPERTY, GEODESY & CADASTAR

|                 |            |
|-----------------|------------|
| DATA/DATUM/DATE | 18.01.2021 |
| NR/BR. 01       | 10/21      |

|                       |  |
|-----------------------|--|
| PËR/ZA/TO             | Kuvendin e Komunës   |
| PËRMES/PREKO/THROUGH  | Znj. Kristina Gashi-Bytyçi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës                            |
| NGA/OD/FROM           | z. Agim Alin, Kryetar i Komunës  |
| LËNDA/PREDMET/SUBJECT | Propozim - Vendim për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale 3273-0 Z.K. Ferizaj |

Në bazë të dispozitave të nenit 5, 21 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 24 pika 1 dhe 5 e Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 58 pika 1.h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

**Propozim-Vendim**

Për:

- I. Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të parcelës 3273-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe 1172 m<sup>2</sup>, ndërmarrjes publike OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A KOSTT me numër identifikues 811284512 me adresë në Prishtinë, rr. "Iljaz Kodra", Republika e Kosovës.

- II. Dhënia në shfrytëzim e parcelës 3273-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe 1172 m<sup>2</sup>, ndërmarrjes publike OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A KOSTT ipet pa kompensim.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim e parcelës së përshkruar më lartë është ndërtimi Nënstacionit NS 110/35/10 (20) kV Ferizaj 3 si dhe traseja për linjën përcjellëse 110 kV dhe nuk mund të shfrytëzohet për asnjë qëllim tjetër pa vendim të Kuvendit Komunal të komunës së Ferizajt.
- IV. OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A KOSST qasjen në parcelën e përshkruar më lartë do ta realizojë përmes parcelave; 3249-2, 497-4 pronë e komunës së Ferizajt dhe përmes parcelës 496-8 me titullar pasuri shoqërore Koperativa Bujqësore.
- V. Parcela 3273-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe 1172 m<sup>2</sup>, ipet në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 99 vjeteve.
- VI. Obligohet Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit që pas miratimit të propozimit-vendimit të bëjë ndërrimin në evidencat kadastrale.

#### Arsyetim

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A KOSST ka ushtruar kërkesë me numer të protokollit 5131/2021 të datës 18.01.2021, me të cilën kërkesë ka kërkuar nga Komuna e Ferizajt dhënie në shfrytëzim të parcelës e cila kufizohet me nënstationin kufizues Ferizaj 35/10 kV të distribucionit KEDS, me qëllim të ndërtimit Nënstacionit NS 110/35/10 (20) kV Ferizaj 3 si dhe traseja për linjën përcjellëse 110 kV.

Bazuar në theksimet e sipërmendura i propozojm Kuvendit të vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

- Të bashkangjiturà i gjeni:
- Kërkesa e KOSTT-it me project ideor me nr. protokollit 5131/2021
- Çeëriifikata e Pronës, kopja e planit.





Formulari per kerkese apo anekese

Drejtorati/Njesia  
Zyra e Kryetarit

Data 18/01/2021

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri  
Kostt

Numri personal  
//

Adresa e vendbanimit  
Prishtinë

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks Numri i tel. mobil

2. Mënyra e pranimit  
Kërkesa

Statusi i lëndës  
Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-353/02-0005131/21

Afati i zgjedhjes

17/02/2021

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Kërkesë për dhënjën e parcelës në shfrytëzim (Pronë Komunale)

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Kostt vërtetoj se informatat e përtshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

\*Ju lutemi të kërkom nga zyrtari/ja fletëdësliminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: Fannol Kallaba



Nr. 1935 Dt. 01-12-2020  
PUSHITINE-A



KUVENDI I KOMUNES FERIZAJ  
SKUPŠTINA OPŠTINE UPOREVAČ  
MUNICIPAL ASSEMBLY FERIZAJ

Drejtori për Urbanizim, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastrë

|            |            |        |  |
|------------|------------|--------|--|
| Pranuar më | 15.01.2021 |        |  |
| Njësia org | 10         | 463-10 |  |

Kuvendit Komunal të Ferizajt

Drejtoratit për Urbanizëm dhe Gjeodezi  
Ferizaj

01 Dhjetor 2020

**Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për 99 vite për ndërtimin e Nënstacionit NS 110/35/10(20) kV Ferizaji 3 ( Kastriot) si dhe trasenë për linjat përcjellëse 110kV**

Të nderuar,

Ndërmarrja Publike, Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT sh.a. me qëllim të furnizimit me energji elektrike më kualitative, zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe shoqërore të Kosovës, në veçanti për rajonin e Ferizajt, bazuar në Planin Zhvillimor 2018-2027, të Sistemit Transmetues të Kosovës ka planifikuar ndërtimin e nënstationit NS 110/35/10(20) kV Ferizaji 3 ( Kastriot), me linjat përcjellëse 110kV në Ferizaj.

Për realizimin e këtij projekti me interes të përgjithshëm publik, me anë të kësaj kërkesë KOSTT sh.a. në pajtim me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës; Ligjit 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e të njëjtit, përfshirë edhe Ligjin 05/L-081 për Energji, pas sigurimit të lokacionit nga ana e juaj, në afërsi të nënstationit ekzistues Ferizaji 35/10kV të distribucionit-KEDS dhe Vendimit për lejimin e ndërtimit të NS në fjalë, kërkon njohjen e të drejtës së shfrytëzimit mbij bazën e dhënies në posedim për 99 vite.

Për më shumë, duke pasur parasysh se nënstationet energjetike janë të një rëndësie të veçantë njëherazi edhe me një rrezikshmëri të lartë është e nevojshme që gjithashtu të sigurohet rruga e qasjes si dhe të bëhet regjistrimi në librat kadastral.

Shtojcë:


1. Projekti Ideor për ndërtimin e nënstationit NS 110/35/10(20) kV duke përfshirë edhe trasenë e linjave, dokumentet ku shihet vendi i propozuar për ndërtimin e nënstationit dhe trasenë e propozuar të linjave 110kV.

Po ashtu, në rast të mos përputhshmërive eventuale në përshkrimin grafik dhe tekstual në njësinë kadastrale, i drejtohem gjithashtu Kadastrit Komunal, që të caktojë Gjeometrin e Komunës, i cili do të dalë në vend të ngjarjes për të bërë identifikimin, ndarjen fizike dhe bashkimin e pasufisë së paluajtshme në pajtim me nenin 12 për matjet kadastrale për regjistrim kadastral të Ligjit NR.04/L – 013 për Kadastër, dhe të vijë deri te njohja e të drejtës së shfrytëzimit me titullar juridik KOSTT sh.a.

Ju faleminderit për mirëkuptim, presim përgjigje pozitive nga ana juaj. Për çdo plotësim shtesë mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,

Mustafë Hasani  
Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT



Alban Imeri  
Drejtor për Zhvillim të Rrjetit dhe Projekteve

per Alban Imeri





NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV  
FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse  
110kV

DT-MP-004

*Verzioni Final*


*Faqe 1 deri 8*

Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit

Projekti ideor: NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI NS 110/35/10kV FERIZAJ 3 me  
LINJËN AJRORË TË DYFISHTË 110kV(PJESËRISHT LINJË KABLLORE TË DYFISHTË) me  
l=3.25km



|   |  |                              |
|---|--|------------------------------|
|  | <b>NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV<br/>FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse<br/>110kV</b> | <b>DT-MP-004</b>             |
|   | <i>Verzioni Final</i>  | <i>Faqe 2 deri 8</i>         |
| Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet                                   |  | Sektori: Zhvillimi i Rrjetit |

## 1. Profili i Kompanisë-Rrjeti i Transmetimit në KOSOVË - KOSTT

KOSTT sh.a është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KOSTT sh.a funksionon në bazë të dy licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Sipas Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike, KOSTT është përgjegjës për:

- planifikimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë;
- operimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmisionit, përfshirë rrjedhat ndërkufitare;
- balancimin e sistemit;
- sigurimin e qasjes jo-diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit;
- nxitjen e konkurrencës efektive për prodhim dhe furnizim me energji elektrike;
- nxitjen e efikasitetit ekonomik në zbatimin e Rregullave të Tregut si dhe kryen aktivitetet në përputhje me Rregullat e Tregut;
- administrimin e tregut të centralizuar të energjisë elektrike në Kosovë;
- menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtarë;

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Sistemit të transmisionit i përkasin edhe transformatorët e ndërlidhur me rrjetin e shpërndarjes: 220/ 35/10 kV dhe 110/35/10(20) kV. Përgjegjësi e KOSTT është që në mënyrë të sigurt dhe të besueshme të transmetojë energjinë elektrike nga njësitë e gjenerimit deri te sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Aktualisht, rrjeti i transmisionit të Kosovës lidhet me shtetet fqinje përmes shtatë linjave ndërkufitare. Në dhjetor 2015 ka përfunduar edhe ndërtimi i linjës së tetë ndërkufitare e cila pritet të hyjë në operim.

Falë pozitës qendrore gjeografike që ka shteti ynë, sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT, edhe pse i vogël, paraqet një nyje shumë të rëndësishme të transmisionit në Evropën Juglindore.





NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV  
FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse  
110kV

DT-MP-004

Verzioni Final

Faqe 3 deri 8

Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit

## 2. Plani Ideor - Përshkrimi i Punëve

### 2.1 Gjenerale

Sektori i energjisë elektrike si një ndër sektorët e rëndësishëm për zhvillimin industrial dhe ndikimi i tij në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, duhet të zhvillohet dhe të planifikohet në mënyrë që të mundësoj transmetimin e energjisë prej prodhimit deri te konsumatorët pa ndërprerje.

Bazuar në planin zhvillimor i rrjetit të transmetimit 2018-2027, i cili paraqet planin zhvillimor për periudhën dhjetëvjeçare ka paraparë ndërtimin e nënstacionit të ri 1100/35/10(20)kV Ferizaj 3 si prioritet për përkrahjen e ngarkesës.

Faktorët kryesor që kanë inicuar ndërtimin e nënstacionit të dytë 110 kV në Komunën e Ferizajit janë:

- Ngritja me shkallë të lartë e kërkesës për energji elektrike si rrjedhojë e shtimit të bizneseve dhe ndërtimit;
- Rrezikimi i sigurisë së furnizimit të konsumatorëve;
- Niveli i lartë i ngarkimit të nënstacionit NS Bibaj si rrjedhojë e furnizimit të konsumatorëve të Kaçanikut dhe Shtërpcë, Brezovicë;
- Kriteri i pa plotësuar N-1 në transformim.


Ferizaj konsiderohet njëri nga rajonet me zhvillim të hovshëm të bizneseve dhe industrisë së vogël me një krahasim pothuajse të ngjashëm me rajonin e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës. Furnizimi i pikave shpërndarëse me vetëm një nënstacion 110 kV nuk garanton siguri të furnizimit dhe si i tillë krijon pengesa në zhvillimin ekonomik të Komunës së Ferizajit me rrethinë duke përfshirë Shtërpcën, Brezovicën dhe Kaçanikun.

Ndërtimi i nënstacionit të ri do të ndikoj në shpërndarjen e rrjedhave të fuqisë nga NS Bibaj në nënstacionin e ri, duke evituar rrezikun e rënies së transformatorëve dhe shkaktimin e sasive të mëdha të energjisë së padërguar tek konsumatorët, me efekt negativ për bizneset, industrinë dhe qytetarët.

### 2.2 Përfitimet e pritshme nga projekti janë:

- Furnizimi i besueshëm dhe kualitativ i konsumit të Ferizajit dhe rrethinës;
- Shkarkimi i transformatorëve në NS Bibaj;
- Reduktimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes
- Reduktimi i sasive të mëdha të energjisë së padërguar te konsumatori si rrjedhojë e eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin e shpërndarjes

Projekti planifikohet të përfundoj në çerekun e katërt të vitit 2021.

|   |  |                              |
|---|--|------------------------------|
|  | <b>NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV<br/>FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse<br/>110kV</b> | <b>DT-MP-004</b>             |
|   | <i>Verzioni Final</i>  | <i>Faqe 4 deri 8</i>         |
| Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet                                   |  | Sektori: Zhvillimi i Rrjetit |

### 2.3 Përshkrimi i punëve për ndërtimin e NS 110/35/10(20)kV Ferizaji 3 – Kastrioti

Ndërtimi i nënstacionit të ri NS 110/35/10(20)kV Ferizaji 3 – Kastrioti, në afërsi të nënstacionit ekzistues 35/10kV të KEDS, që do të thotë në dalje të qytetit në pjesën Veri-Perëndimore pranë fshatit Leshkobarë. Për realizimin e punëve kërkohet nga komuna e Ferizajit, mbështetje dhe përkrahje paraprake në:

- Sigurimi i lokacionit për ndërtimin e nënstacionit;
- Sigurimi rrugës së qasjes në nënstacion;
- Kycja në rrjetin e kanalizimit të qytetit dhe kycja në sistemin e ujërave nga të reshurat atmosferike;
- Kycja në rrjetin e ujësjellësit;

Nënstacioni i ri 110/35/10(20) kV Ferizaji 3 - Kastrioti i cili do të jetë i tipit GIS (Gas Insulated Switchgear) me zbarra të njëfishta:

- një transformator 40MVA - 40/40/40 MVA (YNyn0D5);
- pesë (5) fusha;
- fusha matëse;
- fushë lidhëse;
- AC/DC sistemin;
- fushat 35kV dhe 10 (20)kV;
- sistemin kontrollues dhe mbrojtës;
- punët ndërtimore;
- daljet 10(20) kV do të ndërtohen nga KEDS dhe do të furnizojnë pjesën e konsumit që aktualisht mbulohet nga NS Ferizaj II 35/10 kV. Efektet kryesore në reduktim të humbjeve do të vërehen në rrjetin e shpërndarjes, duke evituar humbjet të transformatorëve 35/10 kV dhe në linjat 35 kV. Për shkak të kostos, fillimisht nënstacioni do të ketë të instaluar vetëm një transformator të fuqisë me kapacitet 40 MVA. Rrjeti ekzistues i shpërndarjes 35kV do të mbetet në shfrytëzim, ndërsa ai 10 kV në një pjesë të madhe të qytetit mund të konvertohet në nivelin 20 kV duke ndikuar në reduktim shtesë të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.





NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV  
FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse  
110kV

DT-MP-004

Verzioni Final

Faqe 5 deri 8

Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit




Fig.1, Skema njëpolare e nënstacionit të ri NS 110/35/10(20)kV Ferizaj

Për ndërtimin e këtij nënstacioni nevojitet hapësirë përafërsisht 25m x 50m.

Duke e pasë parasysh se kompania KEDS i siguron 5m x 50m, atëherë nga Komuna e Ferizajit kërkohet sigurimi i hapësirës /tokës shtesë prej 20m x 50m, në vazhdimësi të parcelës së siguruar nga KEDS, si në figurën 2.

Nënstacioni i ri do të kyqet në linjën ekzistuese 110kV NS Therandë - NS Ferizaj 1, përmes linjës së dyfishtë standarde AIÇe me seksion të përcjellësit 240/40 mm<sup>2</sup> dhe me gjatësi 3.25km dhe linjës kablllore nëntokësore (2x3x1x1000 mm<sup>2</sup>) përafërsisht 300m, prej pikës së prerjes deri te nënstacioni i ri NS 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 – Kastrioti, si në figurën 3.



**NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV  
FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse  
110kV**

**DT-MP-004**

*Verziona Final*

*Faqe 6 deri 8*

Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit




Fig.2- Lokacioni i nërtimit të nënstacionit -




Fig.3, shtrirja gjeografike e projektit dhe linja 110kV





NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV  
FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse  
110kV

DT-MP-004

Verzioni Final

Faqe 7 deri 8

Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit

Për shkak të furnizimit me linjë dyfishtë, kriteri N-1 garantohehet për konsumin deri në 80 MW, fillimisht 40MW dhe në të afërmen e afërt planifikohet shtimi i transformatorit të dytë të fuqisë edhe për 40MW në këtë nënstacion të ri.




Fig.4 Konfigurimi i kyçjes në rrjetin transmetues të NS 110/35/10(20)kV Ferizaj 3

Për funksionalizimin e nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV me linjën 110kV fillimisht duhet të kryhen punët ndërtimore si më poshtë:

- ndërtimi i ndërtesës komanduese;
- ndërtimi bazamenteve për transformator (përfshirë këtu edhe ndërtimin e bazamentit për transformatorin e dytë TR 40MVA);
- ndërtimi i kanaleve për kablo;
- ndërtimi i rrethojës bashkë me sistemin e ndriqimit të nënstacionit;
- Përtokëzimi i nënstacionit;
- rrugët e qasjes mbrenda nënstacionit;
- sistemin e mbrojtjes nga zbrazjet atmosferike;
- etj.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur dizajni bazë i ndërtesës komanduese së bashku me pajisjet e TL 110kV.



NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NS 110/35/10kV  
FERIZAJ 3 me linjat /kablo përcjellëse  
110kV

DT-MP-004

Verzioni Final

Faqe 8 deri 8

Departamenti: Zhvillimi i Rrjetit dhe Projektet

Sektori: Zhvillimi i Rrjetit




Fig.5 Dizajni bazë i ndërtimit të NS 110/35/10(20) kV në lokacionin e propozuar

Dizajni bazë do të shërbej si pike synuese për realizimin e kërkesës për sigurimin e parcelës për ndërtimin e nënstacionit të ri. Ky dizajn gjatë implementimit mund të pësojë ndryshime përgjithnjë duke respektuar hapsirën e lejuar nga Komuna.





Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT  
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT: P-72217092-03273-0


|   |   |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:<br>Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:<br>Komuna / Opština / Municipality:<br>Zona kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone:<br>Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Ferizaj / Uroševac / Ferizaj | 4635/2021<br>15.01.2021 - 14:00<br>Ferizaj / Uroševac / Ferizaj<br>FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ |
|---|---|

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastrarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                      | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> ) | Pëshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Azurirano<br>Updated |
|--|--|---|---------------------------|---|---------------------------------|---|----------------------------------|
| P-72217092-03273-0   | PARCELË / PARCELA<br>/ PARCEL                  | Pronë shoqërore /<br>Društvena<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land | Urban                     | 1172  | 695.2020, RFI.219.2020          | 26.11.2020  |                                  |

A.1 ADRESA E NJËSË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

|  |   |   |   |                                  |
|--|---|---|---|----------------------------------|
| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Azurirano<br>Updated |
| FABRIKA E VAJIT/FABRIKA E VAJIT/FABRIKA E VAJIT                    |   | FABRIKA E VAJIT   | 26.11.2020  |                                  |



**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

| Numbri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina<br>Area (m²) |
|--------------------------|--|--|---|--|
| 1                        | Bujësi/Poljoiprivredno/Agriculture   | Kullosur/Pashjaci/pasture  | Kullosë E Klasës 3/Pashjak 3 Klase/3rd Class Pasture  | 72                                       |
| 2                        | Bujësi/Poljoiprivredno/Agriculture   | Arat/Njive/Arable  | Arë E Klasës 5/Njiva 5 Klase/5th Class Arable Land    | 1100                                     |

**B. PRONARI/POSEDEUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights                                       | Emri<br>Ime<br>Name       | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID.No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postar<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description  | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---------------------------|--------------------------------------|--|---|---|--|--|----------------------------------|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>single possessor | <b>Komuna e Ferizajit</b> | 600629804                            | / / /                                  |   | DESHMORET E KOMBIT  | I/1  | Ndërm i titullarit me kërkesën<br>10 Nr.463-Zyrtarisht nga Sektori<br>i Pronës | 15.01.2021                       |





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : FERIZAJ  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Ferizaj

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type            | Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup> |
|----------------------|----------------------------|--|
| P-72217092-03273-0   | Parcelë / Parcela / Parcel | 1172                                   |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 07.12.2020

Koha/ Vreme/ Time: 09:44:06

Nëshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note

Aprovoi/Usvojic/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nëshkrimi/Potpis/Signature:



## Operator Sistemi, Transmisioni Dhe Tregu - KOSTT SH.A.

|                         |  |
|-------------------------|--|
| Emri i biznesit         | Operator Sistemi, Transmisioni Dhe Tregu - KOSTT SH.A. |
| Emri tregtar            | ///  |
| Lloji biznesit          | Shoqëri aksionare                                      |
| Numri unik identifikues | 811284512  |
| Numri i biznesit        | 70325350   |
| Numri fiskal            | 600323539  |
| Numri certifikues KTA   | ///  |
| Numri punëtorëve        | 217  |
| Data e regjistrimit     | 23/12/2005   |
| Komuna                  | Prishtinë  |
| Adresa                  | Prishtinë, Iljaz Kodra                                 |
| Telefoni                | 038 501 06015  |
| E-mail                  | ///  |
| Kapitali                | 25,000.00€   |
| Statusi në ARBK         | Regjistruar  |
| Statusi në ATK          | ///  |

### Perfaqësues i autorizuar

| Emri  | Mbiemri | Pozita në biznes         | Autorizimet |
|-------|---------|--------------------------|-------------|
| Visar | Hoxha   | Përfaqësues i autorizuar |             |

### Pronar/ Aksionarë

| Emri Mbiemri                              | Kapitali në € | Kapitali në % |
|---|---------------|---------------|
| Republika e kosovës- kuvendi i republikës | 25,000.00€    | 100.00%       |

### Njësitë

| Nr. | Numri i njësisë | Emri | Vendi |
|-----|-----------------|------|-------|
|-----|-----------------|------|-------|

### Aktivitet/et

| Kodi | Përshkrimi   | Tipi      |
|------|--|-----------|
| 3512 | Transmetimi i energjisë elektrike  | Primarë   |
| 2562 | Përpunimi mekanik  | Sekondarë |
| 2712 | Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike                           | Tjera     |
| 5221 | Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor  | Tjera     |
| 4671 | Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to | Tjera     |
| 5814 | Publikimi i revistave dhe periodikëve  | Tjera     |
| 2711 | Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve                                      | Tjera     |



| Kodi | Përshkrimi   | Tipi  |
|------|--|-------|
| 2740 | Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit  | Tjera |
| 9609 | Aktivitetet e tjera p.k.t.   | Tjera |
| 3700 | Kanalizimi   | Tjera |
| 6820 | Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira             | Tjera |
| 6832 | Manaxhimi i patundshmërisë në bazë të pagesës ose kontratës                          | Tjera |
| 3514 | Tregtia e energjisë elektrike  | Tjera |
| 4222 | Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikime | Tjera |
| 6419 | Ndërmjetësimet e tjera monetare  | Tjera |
| 5829 | Publikimi i softuerëve të tjerë  | Tjera |
| 2720 | Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve  | Tjera |
| 8425 | Aktivitetet e shërbimit të zjarrfikësve  | Tjera |
| 8610 | Aktivitetet e spitaleve  | Tjera |
| 6110 | Aktivitetet e telekomunikimit kabllor  | Tjera |
| 4941 | Transporti rrugor i mallrave   | Tjera |
| 3521 | Prodhimi i gazit   | Tjera |
| 5610 | Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit                           | Tjera |
| 2732 | Prodhimi i telave dhe kabllave të tjera elektrike dhe elektronike                    | Tjera |
| 5621 | Furnizimi me ushqim me përosi për raste  | Tjera |
| 5210 | Magazinimi dhe ruajtja   | Tjera |
| 2790 | Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike  | Tjera |
| 4321 | Instalime elektrike  | Tjera |
| 8299 | Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t.                      | Tjera |
| 8411 | Aktivitetet e përgjithshme të administratës publike                                  | Tjera |
| 9329 | Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit                                    | Tjera |
| 5630 | Aktivitetet shërbyese të pijeve  | Tjera |
| 5629 | Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit  | Tjera |
| 5224 | Trajtimi i transportit "cargo"   | Tjera |
| 4329 | Instalime të tjera ndërtimore  | Tjera |

Nr. 1935 dt. 01-12-2020  
PRIËFTINË - A



Drejtoria për Urbanizim, Gjeodezi, Projektim dhe Kadastrim

Kuvendit Komunal të Ferizajt

Drejtoria për Urbanizim dhe Gjeodezi  
Ferizaj

|            |       |        |  |
|------------|-------|--------|--|
| Pranuar më | 15.01 | 2021   |  |
| Njësia org | 10    | 463-10 |  |

01 Dhjetor 2020.

Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për 99 vite për ndërtimin e Nënstacionit NS 110/35/10(20) kV Ferizaji 3 ( Kastriot) si dhe trasenë për linjat përcjellëse 110kV

Të nderuar,

Ndërmarrja Publike, Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT sh.a. me qëllim të furnizimit me energji elektrike më kualitative, zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe shoqërore të Kosovës, në veçanti për rajonin e Ferizajt, bazuar në Planin Zhvillimor 2018-2027, të Sistemit Transmetues të Kosovës ka planifikuar ndërtimin e nënstacionit NS 110/35/10(20) kV Ferizaji 3 ( Kastriot), me linjat përcjellëse 110kV në Ferizaj.

Për realizimin e këtij projekti me interes të përgjithshëm publik, me anë të kësaj kërkesë KOSTT sh.a. në pajtim me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës; Ligjit 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e të njëjtit, përfshirë edhe Ligjin 05/L-081 për Energji, pas sigurimit të lokacionit nga ana e juaj, në afërsi të nënstacionit ekzistues Ferizaji 35/10kV të distribucionit-KEDS dhe Vendimit për lejimin e ndërtimit të NS në fjalë, kërkon njohjen e të drejtës së shfrytëzimit mbi bazën e dhënies në posedim për 99 vite.

Për më shumë, duke pasur parasysh se nënstacionet energjetike janë të një rëndësie të veçantë njëherazi edhe me një rrezikshmëri të lartë është e nevojshme që gjithashtu të sigurohet rruga e qasjes si dhe të bëhet regjistrimi në librat kadastral.

Shtojcë:

1. Projekti Ideor për ndërtimin e nënstacionit NS 110/35/10(20) kV duke përfshirë edhe trasenë e linjave, dokumentet ku shihet vendi i propozuar për ndërtimin e nënstacionit dhe trasenë e propozuar të linjave 110kV.

Po ashtu, në rast të mos përputhshmërive eventuale në përshkrimin grafik dhe tekstual në njësinë kadastrale, i drejtohem gjithashtu Kadastrit Komunal, që të caktojë Gjeometrin e Komunës, i cili do të dalë në vend të ngjarjes për të bërë identifikimin, ndarjen fizike dhe bashkimin e pasurisë së paluajtshme në pajtim me nenin 12 për matjet kadastrale për regjistrim kadastral të Ligjit NR.04/L - 013 për Kadastrë, dhe të vijë deri te njohja e të drejtës së shfrytëzimit me titullar juridik KOSTT sh.a.

Ju faleminderit për mirëkuptim, presim përgjigje pozitive nga ana juaj. Për çdo plotësim shtesë mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,

Mustafë Hasani  
Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT



Alban Imeri  
Drejtor për Zhvillim të Rrejtit dhe Projekteve

per Alban Imeri